

Paruke, Snajpera, kallashnikov, pistoleta me silenciator, eksploziv, gjendet arsenal armësh në garazhin e një pallati te Liqeni i Thatë! 1 i ndaluar (VIDEO)

Snajpera, kallashnikov, armë zjarri automatike, pistoleta me silenciator, fishekë, eksploziv, paruke, pasaporta të falsifikuara...i gjithë ky arsenal armësh ishte i fshehur në garazhin e një pallati në Tiranë, në zonën e Liqenit të Thatë.



[Sh] .com

Redaksia

21 Qershor, 12:09 | Përditësimi i fundit: 21 Qershor, 14:27

📷



TIRANË– Snajpera, kallashnikov, armë zjarri automatike, pistoleta me silenciator, fishekë, eksploziv, paruke, pasaporta të falsifikuara...i gjithë ky arsenal armësh ishte i fshehur në garazhin e një pallati në Tiranë, në zonën e Liqenit të Thatë. Kjo "depo" armësh ishte në pallatit ishte i lokalizuar në rrugën "Peti" në kryeqytetit dhe zbulimi i saj u bë pas informacioneve të marra në rrugë operative.

Garazhi ishte marrë me qira nga 27-vjeçari, me 2 mbiemra, i identifikuar si Eno Papa Beqiri, teksa ky është arsenali i dytë i armëve që është gjetur në Tiranë brenda një harku kohor prej **më pak se një javë**. 27-vjeçari, përveç garazhit dhe armët, iu sekuestruan në cilësinë e provës materiale edhe 3 aparate celulare, 2 laptopë dhe një pasaportë e dyshuar e falsifikuar.



LEXO EDHE:
Zjarri në garazhin në Astir, 3 nga 4 makinat e djegura ishin të Dritan Llanajt, pronarit të pallatit

Ky operacion vjen si vazhdimësi e operacioni "Silent" që u bë pak ditë më parë në 16 qershor, ku në pranga ranë Elvis Bakalli 30 vjeç dhe Dorian Kalo 45 vjeç. Nuk dihet nëse kanë një lidhje mes operacioneve, megjithatë vijojnë hetimet për identifikimin dhe kapjen e personave të tjerë të implikuar në këtë veprimtari kriminale.

Çfarë u gjetën brenda garazhit

2 snajpera, 4 armë zjarri kallashnikov, 2 armë zjarri automatike, 4 armë zjarri pistoleta me silenciator, 85 pako me fishekë të kalibrave të ndryshëm, një sasi e konsiderueshme krehra armësh, pjesë të ndryshme armësh, shënjestra optike për armët e precizionit (snajper), tre kallëpe tritoli, sasi lënde e dyshuar eksplozive, 2 palë portotarga elektrike për fshehjen e targave, një automjet, 3 aparate celulare, 2 laptopë, 5 paruke dhe një pasaportë e dyshuar e falsifikuar.

Rendit zhvillimet sipas orarit: **Të Fundit**

Ora 13:53

Snajpera, kallashnikov, pistoleta me silenciator, eksploziv, del VIDEO nga garazhi që 'fshihte' arsenalin e armëve

2 snajpera, 4 armë zjarri kallashnikov, 2 armë zjarri automatike, 4 armë zjarri pistoleta me silenciator, 85 pako me fishekë të kalibrave të ndryshëm, një sasi e konsiderueshme krehra armësh, pjesë të ndryshme armësh, shënjestra optike për armët e precizionit (snajper), tre kallëpe tritoli, sasi lënde e dyshuar eksplozive, 2 palë portotarga elektrike për fshehjen e targave, një automjet, 3 aparate celulare, 2 laptopë, 5 paruke dhe një pasaportë e dyshuar e falsifikuar. Këto janë gjetur në garazhin e pallatit të Liqeni i Thatë.



B.K./Shqiptarja.com

TAG: Eno Papa Beqiri | arsenal armësh | Tiranë

Komento

🔒 Ndalohej repretësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016



Sondazhi i ditës:
Si e vlerësoni bashkëpunimin mes Shqipërisë e Kosovës?

Të mirë | **Jo të mirë** | **Nuk e di**

Lajme të tjera

Kronikë



VIDEO/ Kujdes kur zgjidhni korsinë kur ktheheni në rrugë, këta drejtues mjetesesh e pësuan

22 Qershor, 10:17

Kronikë



Arrestohen 4 të rinj që bënin 'kërdinë' me vjedhje biçikletash, njëra kishte vlerë 5000 euro! Shpallet në kërkim bashkëpunëtori

22 Qershor, 10:17

Sociale



FOTO/ U dëmtua nga tërmeti, godina e re e gjimnazit 'Sami Frashëri' do të jetë gati në fillim të sezonit të ri shkollor

22 Qershor, 09:17

Politikë



Siguria e këmbësorëve në vijat e bardha Brace publikon videoon virale, thirrja për kryebashkiakun Veliaj: Urgjent! Është super zgjidhje

22 Qershor, 07:24

Politikë



Velliaj takim me strukturat në Kamzë: Partia Socialiste është e fëmijëve dhe e familjeve, jo e non-gratave që mbajtën peng breza me radhë

21 Qershor, 17:18

Kronikë



2100 regjistra të dëmtuar, prokuroria nis hetimet për skandalin në Kadastrën e Tiranës: Abuzimet më të mëdha në zonën e Farkës, Ndroqit, Shëngjergjit

21 Qershor, 15:28

Kronikë



Krime të pazbardhura, priten ndryshime në Policinë e Tiranës! 'Prerje kokash' në disa komisariate, neglizhuan denoncimet në Komisariatin digjital



Arsen Rusta

21 Qershor, 10:32


Kronikë



Sekuestrohet mbi 1 kg kokainë që shitej në Tiranë dhe Lezhë! Arrestohen 2 persona nga policia, vihet nën hetim një tjetër (VIDEO)

21 Qershor, 09:55

Kronikë



I vihet flaka 'Range Roverit' në parkim, shkrumbohen dhe 3 mjete të tjera, lëndohen 8 banorë të pallatit në Astir! Kush është pronari, vëllai i ndërtuesit që u plagos në 2021 (VIDEO)

21 Qershor, 07:09

Kronikë



'Gjysma ime, nuk po të gjej dot se ku je, kjo botë ishte shumë mizore për ty', reagimi për herë të parë i të dashurës së Aleksandër Sadikajt

20 Qershor, 20:15

VIP & Spektakël



Sunny Hill Festival rikthehet sërish në Prishtinë, do të mbahet edhe në Tiranë në datat 26, 27 dhe 28 gusht

20 Qershor, 09:51

Kronikë



U ekzekutua në Tiranë, dalin përgjimet e Aleksandër Sadikajt! Si i humbi arma në bujtinë dhe biseda me nënën: Vriti të gjithë

19 Qershor, 14:21